



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Prezantohet drejtori i Aviacionit Civil, Gjikhuri: Mbroni interesat e udhëtarëve

2017-11-13 10:33:00



Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Damian Gjikhuri prezantoi Drejtorin e ri Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil Krislen Keri. Ai shprehu bindjen se Keri zotëron aftësitë menaxheriale për drejtimin efikas të punëve të përditshme në këtë institucion dhe realizimin e projekteve të tjera për zhvillimin e fushës së aviacionit civil.

Më tej, Gjikhuri u ndal tek orientimet të cilat duhet të ndiqen me prioritet të lartë nga drejtuesi i ri i këtij institucioni. “Nuk mund të themi që fusha e aviacionit civil ka qenë me e sigurta sa i përket sigurisë aeroportuale, ku jo më larg se 1 muaj më parë, një djale i një niveli amator arriti të thyente sigurinë e aeroportit, për të mos përmendur dhe raste të tjera më flagrante. Kjo histori duhet të marrë fund”, u shpreh Gjikhuri ndërsa insistoi se duhet të merren masat që episode të tilla mos të përsëriten më.

Prioritet tjetër sipas tij është ruajtja e pasagjerit shqiptar dhe mbrojtja e interesave të tij në përballjen me kompanitë ajrore.

“Histori pafund të pasagjerëve shqiptarë që lihen ajrore të Italisë apo vendeve tjera, por edhe këtu në Tiranë kemi raste të shumta. Nderkohe që përgjigja e zakonshme është se marrëdhënia qytetar-kompani ajrore është private. Kërkoj angazhim maksimal, deri në qenurit avokati i gjithsecilit që abuzohet nga kompanitë duke i vonuar, anuluar apo mos i lejuar të hipin në bord. Çdo njeri duhet të marrë hakun që i takon në bazë të ligjit, në mënyrë që të dekurajohen kompanitë se bëri keqto lojëra”, nënvizoi Gjikhuri.

Gjikhuri kërkoi gjithashtu angazhimin e Autoritetit të Aviacionit Civil për fillimin e operimit dhe ndërtimit të infrastrukturës aeroportuale shtesë në vend. Ministri kërkoi nga drejtori i ri të ndërmarrë një reformë në institucion pasi kualifikimet e kërkuara për gjithsecilin, përshkrimet e punës lënë për të dëshiruar.